



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**PROJEKTLIGJI PËR HARMONIZIMIN E LIGJEVE TË VEÇANTA ME LIGJIN NR. 05/L-087 PËR
KUNDËRVAJTJE¹**

**DRAFT LAW ON HARMONIZATION OF SPECIAL LAWS WITH LAW NO. 05/L-087 ON MINOR
OFFENCES²**

**NACRT ZAKONA O USKLAĐIVANJU POSEBNIH ZAKONA SA ZAKONOM BR. 05/L-087 O
PREKRŠAJIMA³**

¹ Projektligji për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, është miratuar në Mbledhjen e 180-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 07/180, të datës 27.12.2023.

² Draft Law on Harmonization of Special Laws With Law No. 05/L-087 on Minor Offences, has been approved in the 180th Meeting of the Government of the Republic of Kosovo, through Decision No. 07/180, dated 27.12.2023.

³ Nacrt Zakona o Usklađivanju Posebnih Zakona sa Zakonom Br. 05/L-087 o Prekršajima, je usvojeno na 180 sednici Vlade, Odlukom Br. 07/180, održanoj 27.12.2023.

| | | |
|---|---|--|
| <p>Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR HARMONIZIMIN E LIGJEVE TË VEÇANTA ME LIGJIN NR. 05/L-087 PËR KUNDËRVAJTJE</p> <p>KAPITULLI I</p> <p>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Qëllimi i këtij ligji është ndyshimi dhe plotësimi i Ligjeve në vijim, me qëllim të harmonizimit të tyre me Ligjin Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje:</p> | <p>Assembly of the Republic of Kosovo, Based on Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p>LAW ON HARMONIZATION OF SPECIAL LAWS WITH LAW NO. 05/L-087 ON MINOR OFFENCES</p> <p>CHAPTER I</p> <p>GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>1.The purpose of this law is to amend and supplement the following laws for their harmonization with the Law No. 05/L-087 on Minor Offences:</p> | <p>Skupština Republike Kosovo, Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKONA O USKLAĐIVANJU POSEBNIH ZAKONA SA ZAKONOM BR. 05/L-087 O PREKRŠAJIMA</p> <p>POGLAVLJE I</p> <p>OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Svrha</p> <p>1. Ovaj zakon ima za cilj da izmeni i dopuni sledeće zakone radi njihovog usklađivanja sa Zakonom br. 05/L-087 o Prekršajima:</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>1.1. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës;</p> <p>1.2. Ligji Nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme;</p> <p>1.3. Ligji Nr. 03/L-200 për Greva;</p> <p>1.4. Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin dhe Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;</p> <p>1.5. Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;</p> <p>1.6. Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim;</p> <p>1.7. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;</p> <p>1.8. Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;</p> <p>1.9. Ligji Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare;</p> | <p>1.1. Law No. 03/L-212 on Labour;</p> <p>1.2. Law No. 03/L-022 on Material Support for Families of Children with Permanent Disability;</p> <p>1.3. Law No. 03/L-200 on Strikes;</p> <p>1.4. Law No. 03/L-019 on Vocational Ability, Rehabilitation and Employment of People with Disabilities;</p> <p>1.5. Law No. 04/L-161 on Safety and Health at Work;</p> <p>1.6. Law No. 04/L-110 on Construction;</p> <p>1.7. Law No. 03/L-025 on Environmental Protection;</p> <p>1.8. Law No. 03/L-039 on Special Protective Zones;</p> <p>1.9. Law No. 05/L-062 on Safety at Work in Mining Activity;</p> | <p>1.1. Zakon br.03/L-212 o radu;</p> <p>1.2. Zakon br.03/L-022 o materijalnoj podrsci porodicama dece sa stalnim ogranicenim sposobnostima;</p> <p>1.3. Zakon br.03/L-200 o štrajku;</p> <p>1.4. Zakon br.03/L-019 o profesionalnom osposobljavanju, prekvalifikovanju osoba sa ogranicenim sposobnostima;</p> <p>1.5. Zakon br.04/L-161 o bezbednosti i zdravlju na radu;</p> <p>1.6. Zakon br.04/L-110 o izgradnji;</p> <p>1.7. Zakon br.03/L-025 o zaštiti životne sredine;</p> <p>1.8. Zakon Br.03/L-039 o specijalnim zaštićenim zonama;</p> <p>1.9. Zakon br.05/L-062 o zaštiti na radu u rudarskim delatnostima;</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| 1.10. Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat; | 1.10. Law No. 04/L-147 on Waters; | 1.10.Zakon br.04/L-147 o vodama; |
| 1.11. Ligji Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare; | 1.11. Law No. 08/L-075 on Trademarks; | 1.11. Zakon br.08/L-075 o žigovima; |
| 1.12. Ligjit nr. 08/L -029 për Punimet nga metalet e Çmuara | 1.12. Law No. 08/L-029 on Precious Metal Works; | 1.12. Zakon br.08/L-029 o radovima od plemenitih metala; |
| 1.13. Ligji Nr. 05/L-130 për Shërbime; | 1.13. Law No. 05/L-130 on Services; | 1.13. Zakon br.05/L-130 o uslugama; |
| 1.14. Ligji Nr. 08/L-055 për Dizajnin Industrial; | 1.14. Law No. 08/L-055 on Industrial Design; | 1.14. Zakon br.08/L-055 o industrijskom dizajnu; |
| 1.15. Ligji Nr. 2004/44 për Zejtari; | 1.15. Law No. 2004/44 on Crafts; | 1.15. Zakon br.2004/44 o zanatstvu; |
| 1.16. Ligji Nr. 06/L-033 për Produktet e Ndërtimit | 1.16 Law No. 06/L-033 on Construction Products | 1.16. Zakon br.06/L-033 o građevinskim proizvodima; |
| 1.17. Ligji Nr. 06/L-037 për Metrologji; | 1.17. Law No. 06/L-037 on Metrology; | 1.17.Zakon br.06/L-037 o metrologiji; |
| 1.18. Ligji Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit; | 1.18. Law No. 06/L-041 on Technical Requirements for Products and Conformity Assessment; | 1.18.Zakon br.06/L-041 o tehničkim zahtevima za proizvode i ocenjivanju usaglašenosti; |
| 1.19. Ligji Nr. 08/L-074 për Turizmin; | 1.19.Law No. 08/L-074 on Tourism; | 1.19.Zakon br.08/L-074 o turizmu; |

| | | |
|---|--|--|
| <p>1.20. Ligji nr. 08/L-067 për Inspektimet;</p> <p>1.21. Ligji Nr. 08/L-059 për Patentat;</p> <p>1.22. Ligji Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë;</p> <p>1.23. Ligji Nr. 06/L-031 për Pajisjet në Presion;</p> <p>1.24. Ligji Nr. 05/L-052 për Energjinë Termike;</p> <p>1.25. Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike;</p> <p>1.26. Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë;</p> <p>1.27. Ligji Nr. 05/L-082 për Gazin Natyror;</p> <p>1.28. Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbime të Shoqërive Informatike;</p> <p>1.29. Ligji Nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare;</p> <p>1.30. Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet;</p> | <p>1.20. Law no. 08/L-067 on Inspections;</p> <p>1.21. Law No. 08/L-059 on Patents;</p> <p>1.22. Law No. 06/L-079 on Energy Efficiency;</p> <p>1.23. Law No. 06/L-031 on Pressure Equipment;</p> <p>1.24. Law No. 05/L-052 on Thermal Energy;</p> <p>1.25. Law No. 05/L-085 on Electricity;</p> <p>1.26. Law No. 05/L-081 on Energy;</p> <p>1.27. Law No. 05/L-082 on Natural Gas;</p> <p>1.28. Law No. 04/L-094 on Information Society Services;</p> <p>1.29. Law No. 06/L-038 on Postal Services;</p> <p>1.30. Law No. 03/L-163 on Mines and Minerals.</p> | <p>1.20. Zakon br.08/L-067 o inspekcijskom nadzoru;</p> <p>1.21. Zakon br.08/L-059 o patentima;</p> <p>1.22. Zakon br.06/L-079 o energetskejoj efikasnosti;</p> <p>1.23. Zakon br.06/L-031 o opremi pod pritiskom;</p> <p>1.24. Zakon br.05/L-052 o toplotnoj energiji;</p> <p>1.25. Zakon br.05/L-085 e električnoj energiji;</p> <p>1.26. Zakon br.05/L-081 o energetici;</p> <p>1.27. Zakon br.05/L-082 o prirodnom gasu;</p> <p>1.28. Zakon br.04/L-094 o uslugama informatičkog društva;</p> <p>1.29. Zakon br.06/L-038 o poštanskim uslugama;</p> <p>1.30. Zakon br.03/L-163 o rudnicima i mineralima.</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>1.31. Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.</p> | <p>1.31.Law No. 03/L-233 on Protection of Nature.</p> | <p>1.31. Zakon br. 03/L-233 za zaštitu prirode.</p> |
| <p>KAPITULLI II</p> | <p>CHAPTER II</p> | <p>POGLAVLJE II</p> |
| <p>NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 03/L-212 I PUNËS</p> | <p>AMENDMENT AND SUPPLEMENTATION OF LAW NO. 03/L-212 ON LABOUR</p> | <p>IZMENA I DOPUNA ZAKONA BR. 03/L-212 I O RADU</p> |
| <p>Neni 2</p> | <p>Article 2</p> | <p>Član 2</p> |
| <p>Neni 92 i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës (tutje në këtë kapitull: ligji bazik) ndryshohet me tekstin si në vijim:</p> | <p>Article 92 of Law No. 03/L-212 on Labour (hereinafter in this chapter: basic law) shall be amended with the following text:</p> | <p>Član 92. Zakona br. 03/L-212 o radu (u daljem tekstu: osnovni zakon) menja je sledećim tekstom:</p> |
| <p>“Neni 92 Sanksionet kundërvajtëse me gjobë</p> | <p>“Article 92 Minor offences sanctioned by fines</p> | <p>“Član 92 Prekršajne sankcije novčanom kaznom</p> |
| <p>1. Me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro e deri në pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro dënohet personi juridik nëse:</p> | <p>1. A fine in the amount of two thousand (2,000) euros and up to fifteen thousand (15,000) euros, shall be imposed on a legal entity, if:</p> | <p>1. Novčanom kaznom od dve hiljade (2.000) evra do petnaest hiljada (15.000) evra kazniće se pravno lice ako:</p> |
| <p>1.1 shkelja e dispozites se nenit 10, nese kontrata per periudhe te caktuar eshte lidhur per nje periudhe me te gjate se dhjete (10) vite (neni 10,para. 4)</p> | <p>1.1 violation of provision under Article 10, if the contract on specific time period is entered into for a period longer than ten (10) years (Article 10, para. 4)</p> | <p>1.1 povreda odredbe člana 10. ako je ugovor na određeni period zaključen na period duži od deset (10) godina (član 10. stav 4.)</p> |
| <p>1.2. lidhë kontratë pune me ndonjë person nën moshën pesëmbëdhjetë</p> | <p>1.2. it concludes an employment contract with any person under fifteen (15) years of</p> | <p>1.2.zaključí ugovor o radu sa licem mlađim od petnaest (15) godina doba starosti (član 7. stav 3. Osnovnog zakona);</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>(15) vjeç (neni 7, paragrafi 3 të ligjit bazik);</p> <p>1.3. për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore, punëdhënësi të punësuarin nuk e lajmëron në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera të obligueshme sipas nenit 7, paragrafi 4 të ligjit bazik;</p> <p>1.4. punëdhënësi në sektorin publik nuk shpall konkurs publik për praninë të një punëmarrësi sa herë që praninë një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës sipas nenit 8 të ligjit bazik;</p> <p>1.5. kontrata për një detyrë specifike është më e gjatë se njëqind e njëzet (120) ditë brenda një (1) viti sipas nenit 10, paragrafi 6 të ligjit bazik;</p> <p>1.6. punëdhënësi paraprak punëdhënësin e ardhshëm nuk e informon drejtë dhe plotësisht për të drejtat dhe detyrimet nga Kontrata Kolektive dhe Kontrata e Punës të cilat barten te punëdhënësi i ardhshëm sipas nenit 13, paragrafi 2 të ligjit bazik;</p> | <p>age (Article 7, Paragraph 3 of the basic law);</p> <p>1.3. for the due payment of contributions and other legal obligations, the employer fails to report the employee to the Tax Administration of Kosovo, and other institutions which manage and administer mandatory pension schemes and other mandatory schemes, pursuant to the article 7, paragraph 4 of the basic law;</p> <p>1.4. the employer in the public sector fails to announce a public competition every time when it employs an employee and establishes an employment relationship, pursuant to the Article 8 of the basic law;</p> <p>1.5. the contract for a specified task is longer than one hundred and twenty (120) days within a (1) year pursuant to the article 10, paragraph 6 of the basic law;</p> <p>1.6. the previous employer does not inform the future employer correctly and completely about the rights and obligations from the Collective Agreement and the Labor Contract which are transferred to the future employer pursuant to the Article 13, paragraph 2 of the basic law;</p> | <p>1.3.za plaçanje doprinosa i drugih zakonskih obaveza, poslodavac ne prijavi zaposlenog Poreskoj upravi Kosova, u drugim institucijama koje upravljaju i administriraju obaveznim penzijskim šemama i drugim obaveznim šemama shodno članu 7. stav 4. osnovnog zakona;</p> <p>1.4. poslodavac u javnom sektoru ne objavi javni konkurs za prijem posloprimca svaki put kada primi posloprimca i zasniva radni odnos shodno članu 8. osnovnog zakona;</p> <p>1.5. je ugovor za poseban zadatak duži od sto dvadeset (120) dana u roku od jedne (1) godine shodno članu 10. stav 6. osnovnog zakona;</p> <p>1.6. prethodni poslodavac ne obavesti potpuno i pravo budućeg poslodavca o pravima i obavezama iz Kolektivnog ugovora i Ugovora o radu koje se prenose na budućeg poslodavca u skladu sa članom 13. stav 2. osnovnog zakona;</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>1.7. punëdhënësi paraprak në formë të shkruar nuk i informon të gjithë të punësuarit për bartjen e detyrimeve dhe përgjegjësi tek punëdhënësi i ardhshëm sipas nenit 13, paragrafi 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.8. e punësuarja gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë, e punësuarja me fëmijë deri në moshën tri (3) vjeç, prindi i vetëm me fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç, prindi i punësuar me fëmijë me pengesa të rënda në zhvillim, i punësuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç si dhe i punësuar me aftësi të kufizuara, sistemohen jashtë vendbanimit të tyre, pa pëlqimin e tyre sipas nenit 17, paragrafi 4 të ligjit bazik;</p> <p>1.9. i punësuarit i cili punon në punët dhe detyrat e punës nga paragrafi 1 i këtij neni, punon në punë dhe detyra të njëjta jashtë orarit të punës sipas nenit 22, paragrafi 2 të ligjit bazik;</p> <p>1.10. puna më e gjatë se orari i plotë i punës kryhet në kundërshtim me nenin 23, paragrafët 5, 6, 7, 8 dhe 9 të ligjit bazik;</p> | <p>1.7. the previous employer fails to inform, in writing, all employees about the transfer of obligations and responsibilities to the next employer, pursuant to the article 13, paragraph 3 of the basic law;</p> <p>1.8. an employee during pregnancy, maternity leave, employee with a child up to three (3) years of age, a single parent with a child under five (5) years of age, and employed parent with a child with severe development problems, an employee under eighteen (18) years of age, as well as an employee with disabilities, are reassigned to other habitation without their consent, pursuant to the Article 17, paragraph 4 of the basic law;</p> <p>1.9. the employee, performing tasks and duties under paragraph 1 of this article, performs the same tasks and duties after working hours, pursuant to the article 22, paragraph 2 of the basic law;</p> <p>1.10. extended working hours are performed in violation of article 23, paragraphs 5, 6, 7, 8 and 9 of the basic law;</p> | <p>1.7. prethodni poslodavac u pisanoj formi ne obavesti sve zaposlene o prenosu dužnosti i odgovornosti na sledećeg poslodavca shodno članu 13. stav 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.8. zaposlena tokom trudnoće, porodiljskog odsustva, zaposlena sa decom do tri (3) godine, samohrani roditelji sa decom ispod pet (5) godina starosti, zaposleni roditelji sa decom sa težim smetnjama u razvoju, zaposleni ispod osamnaest (18) godina starosti, kao i zaposleni sa ograničenim sposobnostima, budu raspoređeni van njihovog mesta prebivališta, bez njihove saglasnosti, u skladu sa članom 17. stav 4. osnovnog zakona;</p> <p>1.9. zaposleni koji radi na poslovima i radnim zadacima iz stava 1. ovog člana, radi na istim poslovima i zadacima van radnog vremena iz člana 22. stav 2. osnovnog zakona;</p> <p>1.10. se rad duži od punog radnog vremena obavlja u suprotnosti sa članom 23. st. 5, 6, 7, 8. i 9. osnovnog zakona;</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>1.11. punëdhënësi nuk e informon të punësuarin për ndarjen dhe ndryshimin e orarit të punës, së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punës sipas nenit 24, paragrafi 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.12. ndalimi i zgjatjes së orarit të punës nuk kryhet në pajtim me nenin 26 të ligjit bazik;</p> <p>1.13. puna e natës kryhet në kundërshtim me nenin 27 të ligjit bazik;</p> <p>1.14. i punësuarit punon në ditën e pushimit javor, ndërsa nuk i sigurohet një ditë pushimi gjatë javës së ardhshme sipas nenit 31, paragrafi 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.15. të punësuarit i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pushimit vjetor sipas nenit 38, paragrafi 1 të ligjit bazik;</p> <p>1.16. mbrojtja e përgjithshme në punë nuk kryhet në pajtim me nenin 42, paragrafët 2, 3, 5 dhe 6 të ligjit bazik;</p> <p>1.17. caktimi i të punësuarit në punët që janë me rrezik të shtuar kryhet në</p> | <p>1.11. the employer fails to inform the employee on the division and modification of working hours, at least seven (7) days prior to the commencement of work, pursuant to the article 24, paragraph 3 of the basic law;</p> <p>1.12. the prohibition of the extension of working hours is not carried out in accordance with Article 26 of the basic law;</p> <p>1.13. work carried out during night period is a violation of Article 27 of the basic law;</p> <p>1.14. the employee works on the day of weekly rest, while he is not provided with a day off in the following week, pursuant to the Article 31, paragraph 3 of the basic law;</p> <p>1.15. the employee is denied the right to use annual leave, pursuant to the article 38, paragraph 1 of the basic law;</p> <p>1.16. general occupational protection at work is not carried out in accordance with article 42, paragraphs 2, 3, 5 and 6 of the basic law;</p> <p>1.17. commissioning the employee for hazardous tasks is carried out in violation of Article 43 of the basic law;</p> | <p>1.11. poslodavac ne obavesti zaposlenog o sistematizaciji i promeni radnog rasporeda, najmanje sedam (7) dana pre početka rada, u skladu sa članom 24. stav 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.12. se zabrana produženja radnog rasporeda ne izvrši u skladu sa članom 26. osnovnog zakona;</p> <p>1.13. noćni rad se obavlja suprotno članu 27. osnovnog zakona;</p> <p>1.14. zaposleni radi na dan nedeljnog odmora, a da mu se ne odredi dan odmora u sledećoj nedelji, u skladu sa članom 31. stav 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.15. se zaposlenom uskrati pravo na korišćenje godišnjeg odmora, u skladu sa članom 38. stav 1. osnovnog zakona;</p> <p>1.16. se opšta zaštita na radu ne sprovodi u skladu sa članom 42. st. 2, 3, 5. i 6. osnovnog zakona;</p> <p>1.17. se raspoređivanje zaposlenog na poslove sa povećanim rizikom vrši suprotno članu 43. osnovnog zakona;</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>kundërshtim me nenin 43 të ligjit bazik;</p> <p>1.18. mbrojtja e të rinjve nuk kryhet në pajtim me nenin 45 të ligjit bazik;</p> <p>1.19. mbrojtja e femrave të punësuar nuk kryhet sipas nenit 46, paragrafi 1 dhe 2 të ligjit bazik;</p> <p>1.20. mbrojtja e personave me aftësi të kufizuar nuk kryhet në pajtim me nenin 47 paragrafët 1,2 dhe 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.21. mbrojtja e amësis nuk kryhet në pajtim me nenin 48 të ligjit bazik;</p> <p>1.22. bëhet shkelja e të drejtave lidhur me pushimin e lehonis, të parapra me nenin 49 të ligjit bazik;</p> <p>1.23. shpërndarja e kontratës së punës kryhet në kundërshtim me nenin 53 të ligjit bazik;</p> <p>1.24. lajmërimi për paaftësinë e përkohshme për punë nuk bëhet në pajtim me neni 54 të ligjit bazik;</p> <p>1.25. punëdhënësi nuk ua paguan femrave dhe meshkujve kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensim i cili</p> | <p>1.18. the protection of youth is not carried out in accordance with Article 45 of the basic law;</p> <p>1.19. the protection of women employees is not carried out pursuant to the article 46, paragraph 1 and 2 of the basic law;</p> <p>1.20. protection of persons with disability is not conducted in line with Article 47 paragraphs 1, 2 and 3 of the basic law;</p> <p>1.21 protection of motherhood is not in line with Article 48 of the basic law;</p> <p>1.22. there is violation of rights related to maternity leave, as stipulated with Article 49 of the basic law;</p> <p>1.23. termination of the employment contract is carried out in violation of Article 53 of the basic law;</p> <p>1.24. the notice on temporary incapacity to work, is not made in accordance with Article 54 of the basic law;</p> <p>1.25. the employer fails to pay men and women an equal remuneration for work of equal value, covering the basic salary and</p> | <p>1.18. se zaštita mladih ne sprovodi u skladu sa članom 45. osnovnog zakona;</p> <p>1.19. se zaštita zaposlenih žena ne sprovodi u skladu sa članom 46. stav 1. i 2. osnovnog zakona;</p> <p>1.20.zaštita lica sa ograničenim sposobnostima se ne sprovodi u skladu sa članom 47. stav 1, 2. i 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.21. zaštita materinstva se ne sprovodi u skladu sa članom 48. osnovnog zakona;</p> <p>1.22. postoji povreda prava u vezi sa porodijskim odsustvom iz člana 49. osnovnog zakona;</p> <p>1.23.se prekid ugovora o radu izvrši suprotno članu 53. osnovnog zakona;</p> <p>1.24.obaveštenje za privremenu nesposobnost za rad ne obavi u skladu sa članom 54. osnovnog zakona;</p> <p>1.25. poslodavac ne isplati ženama i muškarcima istu naknadu za rad jednake vrednosti, naknadu koja pokriva osnovnu</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|--|--|
| <p>mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera sipas nenit 55, paragrafi 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.26. punëdhënësi nuk nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve sipas nenit 55, paragrafi 4 i ligjit bazik;</p> <p>1.27. kompensimi i pagës nuk kryhet në pajtim me nenin 58 të ligjit bazik;</p> <p>1.28. punëdhënësi në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, nuk ofron sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme sipas nenit 60, paragrafi 1 të ligjit bazik;</p> <p>1.29. punëdhënësi nuk mban takim me të punësuarin për t'ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t'ia dorëzojë paralajmërimin sipas nenit 70, paragrafi 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.30. procedura para ndërprerjes së kontratës nuk kryhet në pajtim me nenin 72 të ligjit bazik;</p> | <p>any other allowances, pursuant to the article 55, paragraph 3 of the basic law;</p> <p>1.26. the employer fails to issue a salary statement for each salary payment and any other remuneration paid to the employees, pursuant to the Article 55, paragraph 4 of the basic law;</p> <p>1.27. salary compensation is not done in accordance with Article 58 of the Basic Law;</p> <p>1.28. the employer, in case of occupational injuries and illnesses of the employee, sustained in the course of performing work or services, fails to provide insurance for the compensation of expenses, in accordance with this law and other applicable laws, pursuant to the article 60, paragraph 1 of the basic law;</p> <p>1.29. the employer fails to hold a meeting with the employee to explain termination of an employment contract, or for the purpose of issuing a warning, pursuant to the article 70, paragraph 3 of the basic law;</p> <p>1.30. the procedure prior to the termination of the contract is not carried out in accordance with Article 72 of the basic law;</p> | <p>platu i druge dodatke, u skladu sa članom 55. stav 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.26. poslodavac ne izda izjavu za svaku isplatu i svaki drugi plaćeni dodatak zaposlenima, u skladu sa članom 55. stav 4. osnovnog zakona;</p> <p>1.27. se naknada plate ne vrši u skladu sa članom 58. osnovnog zakona;</p> <p>1.28. poslodavac, u slučaju povreda na radu i stručne bolesti zaposlenih, zadobijenih tokom obavljanja poslova, ne pruži osiguranje za naknadu troškova prema ovom zakonu i drugim važećim zakonima, shodno članu 60. stav 1. osnovnog zakona;</p> <p>1.29. poslodavac ne održi sastanak sa zaposlenim da mu/joj objasni raskid ugovora o radu ili da mu/joj uruči upozorenje u skladu sa članom 70. stav 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.30. postupak pre prekida ugovora nije sproveden u skladu sa članom 72. osnovnog zakona;</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>1.31. punëdhënësi nuk i kryen detyrimet në pajtim me nenin 78 të ligjit bazik.</p> <p>2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni me gjobë prej treqind (300) euro e deri në dymijë (2.000) euro dënohet personi përgjegjës në personin juridik dhe personi fizik.</p> <p>3. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni me gjobë prej pesëqind (500) euro e deri në tremijë (3.000) euro dënohet personi fizik i cili ushtron biznes individual.”</p> | <p>1.31. the employer fails to fulfill the obligations in accordance with Article 78 of the basic law.</p> <p>2. For minor offences under paragraph 1 of this article, a fine of three hundred (300) euros and up to two thousand (2,000) euros, shall be imposed on the liable person of the legal entity and on the natural person.</p> <p>3. For minor offences under paragraph 1 of this article, a fine of five hundred (500) euros and up to three thousand (3,000) euros, shall be imposed on a natural person who runs an individual business.”</p> | <p>1.31. poslodavac ne ispuni obaveze u skladu sa članom 78. osnovnog zakona.</p> <p>2. Za prekršaje iz stava 1. ovog člana kažnjava se novčanom kaznom od trista (300) evra do dve hiljade (2.000) evra odgovorno lice pravnog lica i fizičko lice.</p> <p>3. Za prekršaje iz stava 1. ovog člana kažnjava se novčanom kaznom od petsto (500) evra do tri hiljade (3.000) evra fizičko lice koje obavlja individualnu poslovnu delatnost“.</p> |
| <p>KAPITULLI III</p> <p>NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 03/L-022 PËR PËRKRHAJE MATERIALE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR TË PËRHERSHME</p> <p>Neni 3</p> | <p>CHAPTER III</p> <p>AMENDMENT AND SUPPLEMENTATION OF LAW NO. 03/L-022 ON MATERIAL SUPPORT FOR FAMILIES OF CHILDREN WITH PERMANENT DISABILITY</p> <p>Article 3</p> | <p>POGLAVLJE III</p> <p>IZMENA I DOPUNA ZAKONA BR. 03/L-022 O MATERIJALNOJ PODRŠCI DECE SA STALNIM OGRANIČENIM SPOSOBNOSTIMA</p> <p>Član 3</p> |
| <p>Pas nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme (tutje në këtë</p> | <p>After Article 15 of Law No. 03/L-022 on material support for families of children with permanent disability (hereinafter in this</p> | <p>Nakon člana 15. Zakona br. 03/L-022 o materijalnoj podršci dece sa stalnim ograničenim sposobnostima (u daljem tekstu:</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>kapitull: ligji bazik) shtohet neni i ri “24A” me tekstin si në vijim:</p> <p style="text-align: center;">“Neni 24A Sanksionet kundërvajtëse me gjobë</p> <p>1. Me gjobë në shumë prej treqind (300) euro e deri në një mijë (1.000) euro dënohet personi fizik nëse:</p> <p>2. realizon përkrahjen materiale për kujdes dhe ndihmë fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme nuk lajmëron të gjitha ndryshimet që ndikojnë në realizimin e kësaj të drejte sipas nenit 24 paragrafi 2 të ligjit bazik.</p> <p>KAPITULLI IV</p> <p>NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 03/L-200 PËR GREVA</p> <p style="text-align: center;">Neni 4</p> <p>Neni 25 i Ligjit Nr. 03/L-200 për Greva (tutje në këtë kapitull: ligji bazik) ndryshohet me tekstin si në vijim:</p> | <p>chapter: the basic law) a new article “24A” shall be added with the following text:</p> <p style="text-align: center;">“Article 24A Minor offences sanctioned by fines</p> <p>1.A fine in the amount of three hundred (300) euros and up to one thousand (1,000) euros, shall be imposed on a natural person, if:</p> <p>2. the family that realizes the material support for care and help of the children with permanent disability fails to inform all changes that effect the realization of this right, pursuant to the article 24 paragraph 2 of the basic law.</p> <p>CHAPTER IV</p> <p>AMENDMENT AND SUPPLEMENTATION OF LAW NO. 03/L-200 ON STRIKES</p> <p style="text-align: center;">Article 4</p> <p>Article 25 of Law No. 03/L-200 on Strikes (hereinafter in this chapter: basic law) shall be amended with the following text:</p> | <p>osnovni zakon) dodaje se novi član "24A" sa sledećim tekstem:</p> <p style="text-align: center;">“Član 24A Prekršajne sankcije novčanom kaznom</p> <p>1. Novčanom kaznom od trista (300) evra do hiljadu (1.000) evra kazniće se fizičko lice ako:</p> <p>2. ostvaruje materijalnu podršku za staranje o detetu sa stalnim ograničenim sposobnostima i ne prijavi sve promene koje utiču na ostvarivanje ovog prava, shodno članu 24. stav 2. osnovnog zakona.</p> <p>POGLAVLJE IV</p> <p>IZMENA I DOPUNA ZAKONA BR. 03/L-200 O ŠTRAJKU</p> <p style="text-align: center;">Član 4</p> <p>Član 25. Zakona br. 03/L-200 o štrajku (dalje u ovom poglavlju: osnovni zakon) menja se sledećim tekstem:</p> |
|--|--|--|

| <p align="center">“Neni 25 Sanksionet kundërvajtëse me gjobë</p> | <p align="center">“Article 25 Minor offences sanctioned by fines</p> | <p align="center">“Član 25 Prekršajne sankcije novčanom kaznom</p> |
|--|---|---|
| <p>1. Me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro e deri në pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro dënohet personi juridik nëse:</p> <p>1.1. paralajmërimi i grevës nuk bëhet në pajtim me nenin 8 të ligjit bazik;</p> <p>1.2. greva dhe greva e paralajmëruar nuk është organizuar në pajtim me nenin 9 të ligjit bazik;</p> <p>1.3. e drejta në grevë mbahet pa u paraparë lejimi me ligj, me kontratën kolektive dhe me statutin e sindikatës, i punësuar diskriminohet për shkak të organizimit dhe pjesëmarrjes në grevë dhe nëse punëtorit i ndalohet e drejta për grevë apo përdoren masa ndëshkimi për të përfunduar greva sipas nenit 11 të ligjit bazik;</p> <p>1.4. ndaj organizuesve të grevës, pjesëmarrësve grevistë dhe ndaj të punësuarve të tjerë, të cilët mbështesin grevën, merren masa disiplinore apo materiale dhe ju</p> | <p>1. A fine in the amount of two thousand (2,000) euros and up to fifteen thousand (15,000) euros, shall be imposed on a legal entity, if:</p> <p>1.1. the announcement about the strike is not carried out in accordance with Article 8 of the basic law;</p> <p>1.2. the strike and the announced strike were not organized in accordance with Article 9 of the basic law;</p> <p>1.3. the right to strike is maintained, without being foreseen by law, collective contract and trade union statute, the employee is discriminated because of the strike’s organization and participation, and if the worker is prevented from the strike’s right, or the punishment measures are used for ending the strike, pursuant to the Article 11 of the basic law;</p> <p>1.4. the disciplinary or material measures are taken against organizers of strike, strike participants and other employees who support the strike, and the employment relationship is terminated,</p> | <p>1. Novčanom kaznom od dve hiljade (2.000) evra do petnaest hiljada (15.000) evra kazniće se pravno lice ako:</p> <p>1.1. štrajk nije najavljen u skladu sa članom 8. osnovnog zakona;</p> <p>1.2. štrajk i najavljeni štrajk nije organizovan u skladu sa članom 9. osnovnog zakona;</p> <p>1.3. se pravo na štrajk održava a da nije predviđeno zakonom, kolektivnim ugovorom i statutom sindikata, zaposleni je diskriminisan zbog organizovanja i učešća u štrajku i ako je radniku ograničeno pravo na štrajk ili se primenjuju mere kažnjavanja za prekid štrajka u skladu sa članom 11. osnovnog zakona;</p> <p>1.4. se protiv organizatora štrajka, učesnika na štrajku i drugih zaposlenih koji podržavaju štrajk preduzimaju disciplinske ili materijalne mere, i ako im se prekine radni odnos u skladu sa članom 13. stav 1. osnovnog zakona;</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>ndërpritet marrëdhënia e punës sipas nenit 13, paragrafi 1 të ligji bazik;</p> <p>1.5. punëdhënësi punëson punëtor të rinjë të cilët zëvendësojnë pjesëmarrësit në grevën e organizuar në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj sipas nenit 13, paragrafi 2;</p> <p>1.6. greva mbahet ose nuk pezullohet në gjendje të jashtëzakonshme për aq kohë sa vazhdon kjo gjendje sipas nenit 15 të ligjit bazik;</p> <p>1.7. nuk kryhet sigurimi i minimumit të procesit të punës i paraparës sipas nenit 16, paragrafi 1, 2 dhe 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.8. punëdhënësi, personi përgjegjës, këshilli grevist, përfaqësuesi sindikal dhe i punësuar nuk i mundësojnë inspektorit të punës mbikëqyrjen, shikimin e dokumenteve, dhe mospengimin në punën e tij, si dhe nuk i ofrojnë dokumentacionin dhe informatat e nevojshme për kryerjen e inspektimit sipas nenit 23, paragrafi 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.9. shkelen detyrimet e përcaktuara në paragrafët 2,3 dhe 4 të nenit 24 të ligjit bazik.</p> | <p>pursuant to the Article 13, paragraph 1 of the basic law;</p> <p>1.5. during the organized strike according to the conditions determined by this Law, the employer employs the new employees, who replace the participants in the strike, pursuant to the article 13, paragraph 2;</p> <p>1.6. the strike is held or not suspended in case of extraordinary condition, for as long as this condition continues, pursuant to the Article 15 of the basic law;</p> <p>1.7. the minimum security of work process is not ensured, pursuant to the article 16, paragraph 1, 2 and 3 of the basic law;</p> <p>1.8. the employer, the responsible person, the striker council, the trade union representative and the employee fail to enable the labor inspector to supervise, view documents, and not obstruct his work, as well as fail provide him with the necessary documentation and information for conducting the inspection, pursuant to the article 23, paragraph 3 of the basic law;</p> <p>1.9. obligations under paragraphs 2, 3 and 4 of Article 24 of the basic law are violated.</p> | <p>1.5. poslodavac zapošljava nove radnike koji će zameniti učesnike na organizovanom štrajku, u skladu sa uslovima utvrđenim zakonom iz člana 13. stav 2.;</p> <p>1.6. štrajk se održava ili ne obustavlja u vanrednom stanju sve vreme dok traje to stanje, u skladu sa članom 15. osnovnog zakona;</p> <p>1.7. ne sprovodi se obezbeđenje minimuma procesa rada predviđenog članom 16. stav 1, 2. i 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.8. poslodavac, odgovorno lice, štrajkački odbor, sindikalni predstavnik i zaposleni ne omoguće inspektoru rada da vrši nadzor, da izvrši pregled dokumentacije i da ne ometa njegov rad, i ako ne pruže dokumentaciju i potrebne informacije za vršenje inspekcije, u skladu sa članom 23. stav 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.9. krše se obaveze iz st. 2, 3. i 4. člana 24. Osnovnog zakona.</p> |
|---|---|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni me gjobë prej treqind (300) euro e deri në një mijë (1.000) euro dënohet personi përgjegjës në personin juridik dhe personi fizik.</p> <p>3. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni me gjobë prej pesëqind (500) euro e deri në tremijë (3.000) euro dënohet personi fizik i cili ushtron biznes individual.”</p> | <p>2. For minor offences under paragraph 1 of this article, a fine of three hundred (300) euros and up to one thousand (1,000) euros, shall be imposed on the liable person of the legal entity and on the natural person.</p> <p>3. For minor offences under paragraph 1 of this article, a fine of five hundred (500) euros and up to three thousand (3,000) euros, shall be imposed on a natural person who runs an individual business.”</p> | <p>2. Za prekršaje iz stava 1. ovog člana kažnjava se novčanom kaznom od trista (300) evra do hiljadu (1.000) evra odgovorno lice pravnog lica i fizičko lice.</p> <p>3. Za prekršaje iz stava 1. ovog člana kažnjava se novčanom kaznom od petsto (500) evra do tri hiljade (3.000) evra fizičko lice koje obavlja individualnu poslovnu delatnost“.</p> |
| <p>KAPITULLI V</p> <p>NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 03/L-019 PËR AFTËSIMIN DHE RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, I NDRYSHUAR DHE I PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. NR. 05/L-078</p> <p>Neni 5</p> | <p>CHAPTER V</p> <p>AMENDMENT AND SUPPLEMENTATION OF LAW NO. 03/L-019 ON VOCATIONAL ABILITY, REHABILITATION AND EMPLOYMENT OF PEOPLE WITH DISABILITIES, AMENDED AND SUPPLEMENTED BY LAW NO. 05/L-078</p> <p>Article 5</p> | <p>POGLAVLJE V</p> <p>IZMENA I DOPUNA ZAKONA BR. 03/L-019 O PROFESIONALNOM OSPOSOBLJAVANJU, PREKVALIFIKOVANJU I ZAPOŠLJAVANJU OSOBA SA OGRANIČENIM SPOSOBNOSTIMA, IZMENJEN I DOPUNJEN ZAKONOM BR. 05/L-078</p> <p>Član 5</p> |
| <p>Neni 25 i Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin dhe Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (tutje në këtë kapitull: ligji bazik) ndryshohet me tekstin si në vijim:</p> | <p>Article 25 of Law No. 03/L-019 on Vocational Ability, Rehabilitation and Employment of People with Disabilities (hereinafter in this chapter: basic law) shall be amended with the following text:</p> | <p>Član 25. Zakona br. 03/L-019 o profesionalnom osposobljavanju i prekvalifikovanju i zapošlavanju osoba sa ograničenim sposobnostima (u daljem tekstu: osnovni zakon) menja se sledećim tekstom:</p> |

| <p align="center">“Neni 25 Sanksionet kundërvajtëse me gjobë</p> | <p align="center">“Article 25 Minor offences sanctioned by fines</p> | <p align="center">“Član 25 Prekršajne sankcije novčanom kaznom</p> |
|--|---|--|
| <p>1. Me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro e deri në pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro dënohet personi juridik nëse:</p> <p>1.1. punësimi në tregun e hapur të punësimit kryhet në kundërshtim me nenin 12 të ligjit bazik si dhe nenin 7 të Ligjit Nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazik;</p> <p>1.2. si punëdhënës i zyrave të punësimit nuk ua dërgon të dhënat për aftësi të kufizuara që janë të punësuar tek ai/ajo sipas nenit 16 paragrafi 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.3. si punëdhënës i ri nuk i kryen obligimet në pajtim me nenin 17 të ligjit bazik;</p> <p>1.4. si shfrytëzues i destinimeve të veçanta nuk ia dorëzon raportin financiar organit mbikëqyrës për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim si dhe donatorit sipas nenit 22, paragrafi 6 të ligjit bazik.</p> | <p>1. A fine in the amount of two thousand (2,000) euros and up to fifteen thousand (15,000) euros, shall be imposed on a legal entity, if:</p> <p>1.1.the employment in the open labour market is conducted in violation of Article 12 of the Basic Law as well as Article 7 of Law No. 05/L-078 on amending and supplementing the basic law;</p> <p>1.2. the employer of employment offices fails to send the information for people with disabilities to those employed by him/her, pursuant to the Article 16 paragraph 3 of the basic law;</p> <p>1.3.the new employer fails to fulfill his obligations in accordance with Article 17 of the basic law;</p> <p>1.4. the beneficiaries of special destinations fail to submit the financial report to the overseeing body for vocational ability, rehabilitation and employment, as well as to the donor, pursuant to the Article 22, paragraph 6 of the basic law.</p> | <p>1. Novčanom kaznom od dve hiljade (2.000) evra do petnaest hiljada (15.000) evra kazniće se pravno lice ako:</p> <p>1.1. se zapošljavanje na otvorenom tržištu rada vrši suprotno članu 12. osnovnog zakona kao i članu 7. Zakona br. 05/L-078 o izmeni i dopuni osnovnog zakona;</p> <p>1.2.kao poslodavac ne podnese kancelarijama za zapošljavanje podatke o osobama sa ograničenim sposobnostima, shodno članu 16. stav 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.3. kao novi poslodavac ne ispunjava svoje obaveze u skladu sa članom 17. osnovnog zakona;</p> <p>1.4. kao korisnik posebnih destinacija, ne dostavi finansijski izveštaj nadzornom organu za osposobljavanje, stručnu prekvalifikaciju i zapošljavanje kao i donatoru, shodno članu 22. stav 6. osnovnog zakona.</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni me gjobë prej treqind (300) euro e deri në njëmijë (1.000) euro dënohet personi përgjegjës në personin juridik dhe personi fizik.</p> <p>3. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni me gjobë prej pesëqind (500) euro e deri në tremijë (3.000) euro dënohet personi fizik i cili ushtron biznes individual.</p> <p>KAPITULLI VI</p> <p>NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË (MFPT)</p> <p>Neni 6</p> <p>Neni 25 i Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (tutje në këtë kapitull: ligji bazik) ndryshohet me tekstin si në vijim:</p> | <p>2.For minor offences under paragraph 1 of this article, a fine of three hundred (300) euros and up to one thousand (1,000) euros, shall be imposed on the liable person of the legal entity and on the natural person.</p> <p>3.For minor offences under paragraph 1 of this article, a fine of five hundred (500) euros and up to three thousand (3,000) euros, shall be imposed on a natural person who runs an individual business.</p> <p>CHAPTER VI</p> <p>AMENDMENT AND SUPPLEMENTATION OF LAW NO. 04/L-161 ON SAFETY AND HEALTH AT WORK</p> <p>Article 6</p> <p>Article 25 of Law No. 04/L-161 on Safety and Health at Work (hereinafter in this chapter: basic law) shall be amended with the following text:</p> | <p>2. Za prekršaje iz stava 1. ovog člana kažnjava se novčanom kaznom od trista (300) evra do hiljadu (1.000) evra odgovorno lice pravnog lica i fizičko lice.</p> <p>3. Za prekršaje iz stava 1. ovog člana kažnjava se novčanom kaznom od petsto (500) evra do tri hiljade (3.000) evra fizičko lice koje obavlja individualnu poslovnu delatnost.</p> <p>POGLAVLJE VI</p> <p>IZMENA I DOPUNA ZAKONA BR. 04/L-161 O BEZBEDNOSTI I ZDRAVLJU NA RADU (MFRT)</p> <p>Član 6</p> <p>Član 25. Zakona br. 04/L-161 o bezbednosti i zdravlju na radu (u daljem tekstu: osnovni zakon) menja se sledećim tekstem:</p> |
|---|---|---|

| <p align="center">“Neni 25 Sanksionet kundërvajtëse me gjobë</p> | <p align="center">“Article 25 Minor offences sanctioned by fines</p> | <p align="center">“Član 25 Prekršajne sankcije novčanom kaznom</p> |
|--|--|--|
| <p>1. Me gjobë në shumë prej katërmijë (4.000) euro e deri në tridhjetë mijë (30.000) euro dënohet personi juridik nëse:</p> <p>1.1. si punëdhënës detyrimet nuk i kryen në mënyrën e paraparë sipas nenit 5 të ligjit bazik;</p> <p>1.2. si punëdhënës nuk ndërrmer masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurtë, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës sipas nenit 6 paragrafi 1 të ligjit bazik;</p> <p>1.3. si punëdhënës nuk vepron në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike sipas nenit 6 të ligjit bazik;</p> | <p>1.A fine in the amount of four thousand (4,000) euros and up to thirty thousand (30,000) euros, shall be imposed on a legal entity if:</p> <p>1.1.the employer fails to fulfill his obligations in the manner provided by Article 5 of the basic law;</p> <p>1.2.as an employer fails to take health and safety measures at work, including measures for the prevention of professional hazards, information, training of employees for safe work, provision of proper instructions for the use and maintenance of machinery, tools, and equipment, measures for proper organizing of the workflow, pursuant to the article 6 paragraph 1 of the basic law;</p> <p>1.3.the employer fails to continuously act in improving the working conditions to increase the level of safety and health at work, by amending and supplementing previous measures, according to circumstances created with the change of technical and technological processes, pursuant to the Article 6 of the basic law;</p> | <p>1. Novčanom kaznom u iznosu od četiri hiljade (4.000) evra do trideset hiljada (30.000) evra kazniće se pravno lice ako:</p> <p>1.1. kao poslodavac ne ispunjava svoje obaveze na način predviđen članom 5. osnovnog zakona;</p> <p>1.2. kao poslodavac ne preduzima mere za bezbednost i zdravlje na radu, uključujući mere za sprečavanje profesionalnih oboljenja, pružanje informacija, obuka zaposlenih za bezbedan rad, potrebna uputstva za upotrebu i održavanje mašina, instrumenata, opreme i radnih sredstava, mere za organizaciju i napretka procesa rada, u skladu sa članom 6. stav 1. osnovnog zakona;</p> <p>1.3. kao poslodavac ne radi kontinuirano na poboljšanju uslova rada za poboljšanje nivoa bezbednosti i zdravlja na radu, izmenom i dopunom prethodno preduzetih mera u zavisnosti od okolnosti koje su stvorene izmenama tehničko-tehnoloških procesa, shodno članu 6. osnovnog zakona;</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>1.4. si punëdhënës nuk zbaton masat parandaluese në pajtim me nenin 7 të ligjit bazik;</p> <p>1.5. bashkëpunimi i punëdhënësve në zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë nuk kryhet në pajtim me nenin 8 të ligjit bazik;</p> <p>1.6. shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin nuk realizohen në mënyrën e paraparë sipas nenit 9 të ligjit bazik;</p> <p>1.7. si punëdhënës nuk ka caktuar një ekspert për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë sipas nenit 10, paragrafi 2 të ligjit bazik;</p> <p>1.8. si punëdhënës i cili punëson më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar nuk ka angazhuar një (1) ose më shumë ekspertë për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë sipas nenit 10, paragrafi 3 të ligjit bazik;</p> <p>1.9. si punëdhënës nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për ndihmën e parë, fikjen e zjarrit dhe evakuimin e</p> | <p>1.4 the employer fails to apply preventive measures, in accordance with Article 7 of the basic law;</p> <p>1.5. the cooperation of employers in implementing safety and health measures at work, is not carried out in accordance with Article 8 of the basic law;</p> <p>1.6. the protection and prevention services are not carried out in the manner provided by the Article 9 of the basic law;</p> <p>1.7. the employer fails to appoint an expert for carrying out tasks related to safety and health at work, pursuant to the Article 10, paragraph 2 of the basic law;</p> <p>1.8. the employer employing over two hundred and fifty (250) employees fails to engage one (1) or more experts to carry out activities related to safety and health at work, pursuant to the article 10, paragraph 3 of the basic law;</p> <p>1.9.the employer has failed to carry out necessary measures for first aid, fire extinguishing and evacuation of</p> | <p>1.4. kao poslodavac ne sprovodi preventivne mere u skladu sa članom 7. osnovnog zakona;</p> <p>1.5. se saradnja poslodavaca u sprovođenju mera bezbednosti i zdravlja na radu ne ostvaruje u skladu sa članom 8. osnovnog zakona;</p> <p>1.6. zaštitne i preventivne usluge se ne obavljaju na način predviđen članom 9. osnovnog zakona;</p> <p>1.7. kao poslodavac nije odredio eksperta za obavljanje dužnosti bezbednosti i zdravlja na radu, shodno članu 10. stav 2. osnovnog zakona;</p> <p>1.8. kao poslodavac koji zapošljava više od dvesta pedeset (250) zaposlenih, ne određuje jednog (1) ili više stručnjaka za obavljanje dužnosti bezbednosti i zdravlja na radu, shodno članu 10. stav 3. osnovnog zakona;</p> <p>1.9. kao poslodavac ne preduzima potrebne mere za pružanje prve pomoći, gašenja požara i evakuacije radnika, prilagođene</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>të punësuarve, të përshtatura sipas natyrës së aktiviteteve dhe madhësisë së subjekteve punuese, në përputhje me nenin 11 të ligjit bazik;</p> <p>1.10. si punëdhënës nuk ndërmerr masa për caktimin dhe parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale në pajtim me nenin 12 të ligjit bazik;</p> <p>1.11. si punëdhënës nuk i kryen detyrimet për garantimin e zbatimit të masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale sipas nenit 13 të ligjit bazik;</p> <p>1.12. si punëdhënës mjetet e punës nuk i mban në gjendje të rregullt, nuk kontrollon rregullsinë dhe sigurinë e tyre me kontrolla të herëpashershme në afate të përcaktuara me aktin që e miraton ai, përkatësisht me udhëzimin e prodhuesit, dispozitat dhe standardet teknike sipas nenit 14 të ligjit bazik;</p> <p>1.13. objektet/ndërtesat e destinuarat punëdhënësi nuk i siguron në pajtim me nenin 15 të ligjit bazik;</p> | <p>employees, adjust to the nature of activities and the size of the company, pursuant to the Article 11 of the basic law;</p> <p>1.10. the employer fails to determine measures for the prevention of accidents at work and professional illnesses, pursuant to the Article 12 of the basic law;</p> <p>1.11. as an employer, he does not fulfill his obligations to guarantee the implementation of measures for the prevention of accidents at work and occupational diseases pursuant to the Article 13 of the Basic Law;</p> <p>1.12. the employer fails to maintain properly the work equipment, to check their proper functioning and safety with periodical controls in determined deadlines by an act endorsed by him/her, respectively in accordance with manufacturer's instructions, provisions and technical standards, pursuant to the Article 14 of the basic law;</p> <p>1.13. the intended buildings/premises are not provided by the employer in accordance with Article 15 of the basic law;</p> | <p>prirodi aktivnosti i veličini privrednih subjekata, u skladu sa članom 11. osnovnog zakona;</p> <p>1.10. kao poslodavac ne preduzima mere za sprečavanje nesreća na radu i profesionalnih bolesti, shodno članu 12. osnovnog zakona;</p> <p>1.11. kao poslodavac ne ispunjava svoje obaveze o garantovanju sprovođenja mera za sprečavanje nesreća na radu i profesionalnih bolesti, shodno članu 13. osnovnog zakona;</p> <p>1.12. kao poslodavac ne održava radna sredstva u ispravnom stanju, ne kontroliše povremeno njihovu ispravnost i bezbednost u rokovima utvrđenim aktom kojeg on donosi, odnosno uputstvom proizvođača, odredbama i tehničkim standardima, shodno članu 14. osnovnog zakona;</p> <p>1.13. poslodavac ne obezbedi objekte/zgrade namenjene za rad, u skladu sa članom 15. osnovnog zakona;</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|---|
